

# Fondi i Sigurimeve Shoqërore

## Mbulimi financiar i Lejes Prindërore



Democracy for Development  
Demokraci për zhvillim  
Demokratija za razvoj

SOCIAL  
DIALOGUE  
**4 SOCIAL  
JUSTICE**

National Alliance for Social  
Justice & Socio-economic rights



# Fondi i Sigurimeve Shoqërore

## Mbulimi financiar i Lejes Prindërore

Prishtinë, nëntor 2021

Të drejtat e autorit ©2021. Demokracia për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pasazheve të shkurtra me qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Punim i përgatitur nga:

Instituti Demokraci për Zhvillim

Ky punim është realizuar në kuadër të projektit "Dialog social për drejtësi shoqërore" që implementohet nga Demokraci për zhvillim, pjesë e Koalicionit për drejtësi sociale dhe të drejta socio-ekonomike, që financohet nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme dhe mbështetet nga Qeveria Suedeze. Përmbajtja e këtij punimi nuk reflekton doemos mendimet e Qendrës Ndërkombëtare Olof Palme dhe Qeverisë Suedeze.

## Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	5
Hyrje.....	11
Sistemi i mbrojtjes shoqërore në Kosovë.....	12
<i>Rregullimi i tanishëm i lejes së lehonisë dhe lejes prindërore .....</i>	<i>14</i>
Shembuj nga disa vende Evropiane .....	15
Analizë e shkurtë e disa dokumenteve publike rreth Fondit për Sigurime Shoqërore dhe Lejes Prindërore .....	21
<i>Koncept Dokumenti i MPMS per Sigurimet Shoqërore.....</i>	<i>21</i>
<i>Koncept Dokumenti i Komisionit AD-Hoc për Sigurime Shoqërore ..</i>	<i>23</i>
<i>Punimet tjera rreth fondit për sigurime shoqërore dhe lejes prindërore .....</i>	<i>27</i>
Modalitetet e mundshme të lejes prindërore.....	29
<i>Modeli sipas Direktivës për Balancim Punë-Jetë .....</i>	<i>31</i>
<i>Modeli sipas komisionit ad-hoc parlamentar për reformë pensionale .....</i>	<i>32</i>
<i>Modeli sipas D4D propozuar në vitin 2017.....</i>	<i>34</i>
Modeli i rekomanduar .....	36

## Lista e tabelave

Tabela 1. Skemat pensionale të financuara nga shteti për vitin 2020 .....	5
Tabela 2. Përfituesit dhe shuma e përfituar nga FKPK për vitin 2020 .....	7
Tabela 3. Përfituesit dhe shuma e paguar për ndihmat sociale për vitin 2020.....	7
Tabela 4. Leja e Lehonisë 2020 .....	8
Tabela 5. Shembuj nga disa shtetet europiane të lartësisë së kontributeve të paguara.....	16
Tabela 6. Propozimi i MPMS-së për fondin për mbrojtje shoqërore.....	22
Tabela 7. Sistemi pensional dhe mbrojtja shoqërore – komisioni ad hoc .....	24
Tabela 8. Parashikimi për kontribute sipas shtyllave.....	26
Tabela 9. Modeli sipas Direktives së UE-së .....	31
Tabela 10. Kostot sipas modelit të Komisionit Ad-hoc.....	33
Tabela 11. Kostoja sipas modelit të D4D-së .....	35
Tabela 12. Përgjigjet në pyetjen e parashtruar nga D4D ....	36
Tabela 13. Përgjigjet në pyetjen e parashtruar nga D4D .....	37
Tabela 14. Përgjigjet në pyetjen e parashtruar nga D4D ...	38
Tabela 15. Kontributet dhe dedikimi i tyre sipas komisionit ad hoc .....	39
Tabela 16. Kosto e modelit të rekomanduar .....	40

## Përmbledhje ekzekutive

Sistemi pensional në Kosovë është i financuar nga buxheti i Republikës së Kosovës sipas Ligjit 04/L-131<sup>1</sup> për skemat pensionale të financuara nga shteti. Gjithashtu skemat sociale financohen nga buxheti shtetëror dhe janë të rregulluara sipas Ligjit Nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë. Në vitin 2020<sup>2</sup>, 24 skemat pensionale i kanë kushtuar buxhetit të shtetit rreth 466 milion euro.

**Tabela 1. Skemat pensionale të financuara nga shteti për vitin 2020**

Skemat pensionale të financuara nga buxheti i Kosovës			
Nr. i SK	Skemat Pensionale	2020	
		Nr. Mes. i perf.	total
1	Bazik	139,933	€ 165,815,340
2	I paaftësisë	18,075	€ 20,031,305
3	Kontributpagues para 1999	49,083	€ 119,944,333
4	Invalitorë i punës	92	€ 108,270
5	Familjar	3,727	€ 4,389,208
6	Trepça	2,458	€ 3,732,315
7	Me shikim të dëmtuar	1,928	€ 5,251,088
8	Tetraplegjik dhe paraplegjik	2,984	€ 11,385,204
9	TMK	1,132	€ 3,019,553
10	FSK	568	€ 2,739,875
11	Veteranët e luftës	36,222	€ 73,969,327

<sup>1</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, 05 Qershor 2014, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9517>.

<sup>2</sup> Agjencioni I Statistikave të Kosovës, Mirëqenia Sociale, <https://ask.rks-gov.net/media/5983/statistikat-e-mir%C3%ABqenies-sociale-tm4-2020.pdf>

Fondi i Sigurimeve Shoqërore

12	Familjarët e veteranëve	1,975	€ 2,842,814
13	VHDS	795	€ 2,247,237
14	K. i Arsimit	1,167	€ 8,535,168
15	Familjet e dëshmorëve	2,329	€ 12,933,385
16	Invalid i Luftës së UÇK-së	4,670	€ 15,989,338
17	Invalid civil i luftës	1,809	€ 2,734,944
18	Viktimë Civile e Luftës	3,934	€ 8,358,984
19	Kujdestar për invalid të luftës	83	€ 229,725
20	Kujdestar për familjet e invalidëve të luftës pas vdekjes së tyre	211	€ 658,097
21	Kujdestar për familjet e të pagjeturve në luftë	18	€ 101,725
22	Kujdestar për invalid civil të luftës	32	€ 19,851
23	familjet e personave civil të pagjetur	327	€ 695,599
24	Familjet e invalidëve civil pas vdekjes së tyre	112	€ 138,090
<b>Nr. i perf. dhe shuma</b>		<b>283,664</b>	<b>€ 465,870,775</b>

Vetëm një numër i vogël pensionistësh përfitojnë pension nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës<sup>3</sup> (FKPK). Përkatësisht, në vitin 2020 kanë qenë qenë 7,078 përfitues të rinjë të pensionit nga ky fond, derisa që nga themelimi i tij në vitin 2002, prej këtij fondi kanë përfituar gjithsej 58,390 persona. Në shtigje afatgjata parashihet që FKPK-ja të jetë ofruesi i vetëm i pensioneve që ndërlidhen me kontributet e paguara, derisa skemat tjera, nëse nuk ndryshon sistemi pensional, do të vazhdojnë të paguhen nga buxheti i shtetit.

<sup>3</sup> Fondi I Kursimeve Pensionale të Kosovës, Raporti Vjetor 2020, [http://www.trusti.org/wp-content/uploads/2020/12/RaportiVjetor\\_2020\\_shq\\_uebf.pdf](http://www.trusti.org/wp-content/uploads/2020/12/RaportiVjetor_2020_shq_uebf.pdf)

**Tabela 2. Përfituesit dhe shuma e përfituar nga FKPK për vitin 2020**

TRUST-I 2020		
Perf. Per 2020	Vlera totale	Vlera mesat vjetore
7,078	49,608,754	16,987,200

Nga FKPK për vitin 2020 për 7,078 përfitues janë paguar rreth 50 milion euro të cilat do t'u paguhen në baza mujore këtyre pensionistëve. Nëse marrim parasysh që shuma minimale që FKPK paguan është 200 euro në muaj atëher i bie që gjatë vitit 2020 janë paguar rreth 17 milion euro. Këto të dhëna tregojnë se rreth 97% të skemave pensionale mbulohen nga buxheti i shtetit derisa ndihmat sociale mbulohen 100% nga ky buxhet.

Ndihmat sociale<sup>4</sup> gjatë viti 2020 buxhetit të shtetit i kanë kushtuar rreth 47 milion euro.

**Tabela 3. Përfituesit dhe shuma e paguar për ndihmat sociale për vitin 2020**

Pagesat e ndihmave sociale gjatë vitit 2020		
Nr. Fam.	Ant. e fam.	Shuma
24,675	99,651	€ 47,008,042

Përfituese të pagesës së lejes së lehonisë gjatë vitit 2020 kanë qenë gjithsej 2,686 përfituese, ku shuma e kompensimit në total për vitin 2020 ka qenë mbi 1.8 milion euro të financuara nga shteti. Tabela e mëposhtme tregon numrin e përgjithshëm të përfituesve të lejes së lehonisë si dhe ndarja e tyre sipas sektorëve se ku kanë qenë të punësuar.

<sup>4</sup> Agjencioni I Statistikave të Kosovës, Mirëqenia Sociale, <https://ask.rks-gov.net/media/5983/statistikat-e-mir%C3%ABqenies-sociale-tm4-2020.pdf>

Tabela 4. Leja e Lehonisë 2020

Përfituesit e pagesës së lehonisë 2020		
Nr. i përgjithshëm i përfituesve	Nr. i përfituesve në sektorin public	Nr. i përfituesve në sektorin privat
2,686	992	1,694
<b>Kostoja e përgjithshme për vitin 2020</b>		<b>€ 1,819,031</b>

Pasi që mungon një sistem i mirëfilltë i mbrojtjes shoqërore, grupe të ndryshme të interesit kanë arritur të futen si përfitues të mbrojtjes sociale por grupe të tjera kanë mbetur jashtë kësaj skeme. Si rrjedhojë e kësaj politike, në Kosovë sot ka mbi 23 skema të ndryshme pensionale dhe të ndihmës sociale dhe një shumësi ligjesh që e rregullojnë këtë fushë. Duke parë mangësitë e këtij sistemi, duke filluar nga viti 2017 deri në vitin 2019 ka filluar diskutim i gjerë rreth krijimit të fondit të sigurimeve shoqërore. Ky diskutim i filluar nga shoqëria civile më grupe të ndryshme interesi si pensionistët, sindikatat, odat ekonomike si dhe me institucionet relevante, ka arritur që në vitin 2019 të futet në agjendën zyrtare të qeverisë dhe të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Si rezultat i diskutimeve të vazhdueshme me grupe të interesit dhe ekspertë të fushës së sigurimeve shoqërore, janë publikuar disa studime dhe raporte që e trajtojnë gjendjen aktuale si dhe rekomandime rreth krijimit të fondit për sigurime shoqërore. Gjatë viteve 2017 dhe 2018 janë publikuar 4<sup>5</sup> punime nga organizata joqeveritare që temë kryesore kanë fondin për sigurime shoqërore si dhe politikat e lejes së lehonisë. Përkatësisht, dy punime janë realizuar nga Instituti

<sup>5</sup> INDEP, Pensionet në Kosovë-Sfidat dhe Mundësitë, <https://indep.info/wp-content/uploads/2018/05/Sistemi-Pensional-n%C3%AB-Kosov%C3%AB-Sfidat-dhe-Mund%C3%ABsit%C3%AB-2.pdf>. INDEP, Reforma Pensionale Rruga që duhet ndjekur, [https://indep.info/wp-content/uploads/2018/10/Reforma-Pensionale\\_Rruga-qe-duhet-ndjekur\\_INDEP.pdf](https://indep.info/wp-content/uploads/2018/10/Reforma-Pensionale_Rruga-qe-duhet-ndjekur_INDEP.pdf). Demokraci për Zhvillim-D4D, Ndryshimi I Paradigmës-Barazi përmes lejes prindërore, [https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/D4D\\_PI\\_13\\_SHQ\\_WEB.pdf](https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/D4D_PI_13_SHQ_WEB.pdf).

për Politika Zhvillimore (INDEP) për skemat pensionale dhe nevojën e reformës në këtë sektor, një punim nga Friedrich-Ebert-Stiftung (FES) për koston e mundshme të fondit për sigurime shoqërore, si dhe një punim nga Instituti Demokraci për zhvillim (D4D) për lejen prindërore.

Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës në fund të vitit 2018 dhe gjatë vitit 2019, kanë përgatitur dy dokumente zyrtare lidhur me reformën pensionale që në thelb kishin krijimin e fondit për sigurime shoqërore. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përgatiti Koncept Dokumentin (KD) për reformën pensionale si dhe Kuvendi i Kosovës përmes komisionit ad-hoc parlamentar përgatiti gjithashtu dokumentin për reformë pensionale që gjithashtu në thelb kishte krijimin e Fondit për Sigurime Shoqërore. Që atëherë kjo temë më nuk është diskutuar apo nuk është futur në agjendë të qeverive apo kuvendeve që kishin pasuar, ndoshta edhe për shkak të jetëgjatësisë së shkurtë të qeverive pasuese dhe jostabilitetit politik.

Ky punim synon të analizojë disa nga dokumentet e përgatitura gjatë viteve 2017-2019 me fokus të veçantë në modalitetet e diskutuara për krijimin e fondit për sigurime shoqërore si dhe ndërlidhjen e fondit me lejen prindërore. Shikuar nga konteksti i së tashmës, duke marrë parasysh edhe aprovimin e Direktivës Evropiane Balancin Punë-Jetë 2019/1158<sup>6</sup> mbi lejen prindërore, do të rekomandohet modaliteti i cili ka potencial të nxisë qeverinë aktuale dhe Kuvendin e Kosovës që të ri-aktivizohet trajtimi i kësaj teme.

Opsioni i rekomanduar nga ky punim është në përputhje me Direktivën Evropiane për balancë jetë-punë 2019/1158, si dhe tenton të balancojë interesat e ndryshëm të grupeve të interesit mbi këtë temë. Ky opsion rekomandon lejen e

---

<sup>6</sup> Bashkimi Europian, Direktiva 2019/1158, [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32019L1158&qid=1634928676900#ntr6-L\\_2019188EN.01007901-E0006](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32019L1158&qid=1634928676900#ntr6-L_2019188EN.01007901-E0006)

lehonisë dhe lejen prindërore në kohëzgjatje prej 10 muaj e gjysmë, ku leja e lehonisë do të ishte 4 muaj me pagesë prej 70% të pagës bazë dhe dy muaj leje prindërore për nënën me pagesë prej 50% të pagës bazë. Leja e atësisë parashihet të jetë 2 javë me kompensim prej 70% të pagës bazë, derisa leja prindërore për babain do të ishte 2 muaj me pagesë prej 50% të pagës bazë. Gjithashtu prindërit do të kishin në dispozicion 2 muaj (një muaj secili) të lejes prindërore pa pagesë. Financimi i tërësishëm i lejes së lehonisë, lejes së atësisë dhe lejes prindërore do të mbulohej nga Fondi për Sigurime Shoqërore.

## Hyrje

Qëllimi i këtij studimi është të rishikojë modalitetet dhe qëndrueshmërinë e një fondi të sigurimeve shoqërore, i cili do të përdoret për të mbuluar lejen e lehonisë dhe lejen prindërore. Mbrojtja e të ardhurave të prindërve të rinj është një temë e cila ka tërhequr interes të konsiderueshëm gjatë dekadës së fundit. Në veçanti, mbrojtja e të ardhurave të lehonisë synon të sigurojë të ardhura për një nënë që punon para dhe pas lindjes ose birësimit të fëmijës së saj. Mbrojtja e të ardhurave të lehonisë kontribuon në mbrojtjen e lehonisë me elementë të tjerë përbërës, si: lejen e lehonisë, përfitimet mjekësore, mbrojtja shëndetësore në vendin e punës, mbrojtja e punësimit, mosdiskriminimi dhe rregullimet e gjdhënies në punë. Ky raport përqendrohet në analizën e modaliteteve për mbulimin e lejes së lehonisë dhe lejes prindërore.

Pika kryesore të diskutimit të këtij raporti janë raportet zyrtare dhe jozyrtare të përgatitura në vitet e fundit që kanë si fokus krijimin e Fondit për Sigurime Shoqërore dhe lejen prindërore. Nga analiza e këtyre dokumenteve do të rekomandohet hartimi i një skeme të përballueshme të mbrojtjes sociale dhe lejen prindërore, që do të ishte në linjë me rekomandimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO)<sup>7</sup> si dhe me Direktivën Evropiane për Balancin jetë-punë.<sup>8</sup>

---

<sup>7</sup> International Labour Organization, Maternity, Paternity at work, [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---gender/documents/briefingnote/wcms\\_410183.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---gender/documents/briefingnote/wcms_410183.pdf)

<sup>8</sup> Bashkimi Europian, Direktiva 2019/1158, [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32019L1158&qid=1634928676900#nr6-L\\_2019188EN.01007901-E0006](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32019L1158&qid=1634928676900#nr6-L_2019188EN.01007901-E0006)

## Sistemi i mbrojtjes shoqërore në Kosovë

Sistemi aktual i mbrojtjes shoqërore në Kosovë i ka disa karakteristika të cilat janë specifike dhe vështirë të gjenden në ndonjë vend tjetër. Për dallim nga shumë shtete evropiane, Kosova nuk ka fond të mbrojtjes sociale. Në mungesë të këtij fondi, mbrojtja e kategorive të ndryshme bëhet në forma të ndryshme përmes ligjeve të veçanta dhe financohet nga buxheti i Kosovës.

Përveç skemave të ndryshme pensionale që në masën më të madhe janë të financuara nga buxheti i Kosovës, gjithashtu edhe skemat sociale financohen 100% nga buxheti i Kosovës. Në anën tjetër, pjesa më e madhe e lejes së lehonisë pjesa financohet nga buxheti i shtetit dhe një pjesë nga punëdhënësi. Së fundmi në vitin 2021, me vendim<sup>9</sup> të qeverisë ka filluar edhe pagesa shtesë e lehonave si dhe pagesave për fëmijë, që si bazë ka Pakon e Ringjalljes Ekonomike. Kjo pako, e cila mbulohet gjithashtu nga buxheti i Kosovës, së pari është filluar me fëmijët deri në moshën 2 vjeçare dhe në faza të ndryshme do të vazhdojë edhe për fëmijët tjerë deri në moshën 18 vjeçare. Ky vendim qeveritar nuk dihet se sa do të zgjasë dhe a do të aprovohet ndonjë ligj i ri në mënyrë që kjo mbështetje financiare të mos mbetet vetëm më vendim qeveritar. Sistemi aktual i mbrojtjes sociale në Kosovë nuk parasheh mbrojtjen nga papunësia, sëmundjeve afatgjate, aksidenteve në punë, si dhe nuk ka sigurim shëndetësor.

Në përgjithësi në periudha të ndryshme kohore janë aprovuar ligje të ndryshme për përkrahje financiare për grupe të ndryshme. Grupe të ndryshme të interesit përmes lobimit kanë arritur që të jenë përfitues të beneficioneve financiare nga buxheti i shtetit si ligji për personat e verbër, ligji për

---

<sup>9</sup> Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4F250604-F09F-481F-B678-EB53F7BE9BEF.pdf>

persona paraplegjik dhe tetraplegjik, si dhe shtesat për puntorët e arsimit në vitet 90-ta. Në anën tjetër, kemi grupe të tjera që kane mbetur të pambrojtura me ligje specifike, si personat me Sindromin Doën, me autizëm, etj., dhe që në të ardhmen përmes lobimit sikurse grupet tjera do të arrijnë të përfitojnë ligjë të veçantë për mbështetje financiare.

Numri i përfituesve gjatë viteve është rritur vazhdimisht ashtu si edhe shuma totale që paguhet nga buxheti i shtetit. Gjatë vitit 2020 kanë qenë rreth 283 mijë përfitues të skemave pensionale, duke përfshirë përreth 27 mijë familje me rreth 100 mijë anëtarë ku kostoja totale për këto kategori gjatë vitit 2020 ka arritur në rreth 513 milion euro.

Krijimi i një sistemi të mirëfilltë të mbrojtjes sociale ndërlidhet me kontributet e paguara nga punëdhënësi, punëmarrësi dhe sipas nevojës edhe nga shteti në fondin për mbrojtjen shoqërore.

Sistemi aktual në Kosovë parasheh kontributet e paguara në paga deri në 20%. 10% të pagës (5% punëdhënësi dhe 5% punëmarrësi) paguhet në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), si dhe pagesën deri në 10% si tatim në të ardhura që paguhet në mënyrë progresive varësisht nga lartësia e pagës. Përkatësisht, për të ardhurat vjetore deri në 960 euro, tatimi është 0%; për të ardhurat vjetore nga 960-3000 euro paguhet 4% tatim; për të ardhurat vjetore nga 3000 deri 4500 euro paguhet 8% tatim dhe për të ardhurat vjetore nga 5400 euro e tutje paguhet 10% tatim në të ardhura.<sup>10</sup> Kontributet e paguara në FKPK janë mjete të cilat pas moshës 65 vjeçare iu kthehen kontributpaguesve në baza mujore nëse është mbledhur një shumë e caktuar ashtu siç parasheh ligji. Për kategoritë tjera që përfitojnë financiarisht nga buxheti i shtetit, nuk ka një linjë të veçantë të kontributeve që paguhet për këto grupe përfituese.

---

<sup>10</sup> Administrata Tatimore e Kosovës, Sistemi tatimor në Kosovë, <https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2019/03/SistemiTatimorShkollateMesme.pdf>

## *Rregullimi i tanishëm i lejes së lehonisë dhe lejes prindërore*

Pasiqë qëllimi i këtij punimi është rishikimi i mbulueshmërisë financiare të lejes së lehonisë dhe lejes prindërore, pjesa në vijim fokusohet në rregullimin aktual të kësaj çështje.

Leja e lehonisë aktualisht është i rregulluar me Nenin 49 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212.<sup>11</sup> Sipas këtij ligji lehonat kanë të drejtë në leje të lehonisë deri në 12 muaj, ku 6 muajt e parë paguhen nga punëdhënësi në shumën 70% të pagesë, 3 muaj paguhen nga buxheti shtetit në shumën 50% të pagesë bazë, si dhe nëse lehona dëshiron mund t'i shfrytëzoj edhe tre muaj të tjerë pa pagesë.<sup>12</sup> Neni 50, pika 1 e Ligjit të Punës parasheh edhe të drejtat e babait të fëmijës ku shprehimisht thuhet se “Të drejtat e përcaktuara sipas nenit 49 të këtij ligji mund t'i realizojë edhe i ati i fëmijës me rastin e sëmundjes së nënës, braktisjes së fëmijës nga nëna dhe vdekjes së nënës”.<sup>13</sup> Pra vetëm në rastet e përmendura në nenin 50, i ati ka të drejtat e njëjta si e ëma, përndryshe babai ka të drejtë në dy ditë leje me pagesë me rastin e lindjes së fëmijës si dhe mund t'i shfrytëzojë 2 javë pa pagesë pas lindjes së fëmijës dhe atë në periudhën derisa fëmija t'i mbush 3 vjet.<sup>14</sup>

Nëse e shikojmë se si ligji e rregullon çështjen e lejes së lehonisë, i vërejmë disa karakteristika në krahasim me vendet e Bashkimit Europian. Për nga gjatësia leja është mjaft i gjatë, meqë shkon deri në 36 javë me pagesë si dhe me mundësi edhe për 12 javë pa pagesë, që i bie maksimum deri në 48

<sup>11</sup> Gazeta Zyrtare, Ligji I Punës Nr.03/L-212, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735>

<sup>12</sup> Gazeta Zyrtare, Ligji I Punës Nr.03/L-212, Neni 49, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735>

<sup>13</sup> Gazeta Zyrtare, Ligji I Punës Nr.03/L-212, Neni 50 pika 1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735>

<sup>14</sup> Gazeta Zyrtare, Ligji I Punës Nr.03/L-212, Neni 50 pika 3, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735>

javë. Sipas direktivës së BE-së për leje të lehonisë, atësisë, dhe prindërimit, leja e lehonisë është minimum 14 javë.<sup>15</sup>

Derisa në shumë shtetet të BE-së leja e lehonisë apo mbrojtja prindërore parasheh në forma të ndryshme lejen edhe për nënën edhe për të atin e fëmijës, në Kosovë kjo është e rregulluar ndryshe pasi që leja për të atin është vetëm në raste të veçanta. Mënyra e pagesës në shtetet e BE-së është kryesisht e lidhur me kontributet e paguara në fondin e mbrojtjes shoqërore përderisa në Kosovë pagesa bëhet drejtpërdrejtë nga punëdhënësi si dhe nga buxheti i shtetit.

Këto tri pika janë qenësore dhe kërkojnë rishikim për të i'u përafuar BE-së jo vetëm për shkak të aspiratave të Kosovës për integrim evropian, por për më shumë rishikimi duhet të bëhet për arsye pragmatike duke shikuar interesin e nënës, të atit, punëdhënësit, fëmijës dhe të shtetit. Balancimi i këtyre interesave do të ofronte zgjidhjen më të mirë pasi që zgjidhja momentale nuk konsiderohet e mjaftushme, nëse e krahasojmë me shembujt e shteteve të BE-së por edhe në praktikë nuk është treguar se kjo zgjidhje është më e mira në Kosovë.

## Shembuj nga disa vende Evropiane

Vendet e Bashkimit European (BE) kanë një sistem të zhvilluar të mbrojtjes shoqërore për dallim nga Kosova. Gjithashtu brenda BE-së ka dallime se si funksionon ky sistem por të gjitha kanë një gjë të përbashkët për dallim nga Kosova –kontributet e paguara në sistemin e mbrojtjes shoqërore janë shumë më të larta se në Kosovë. Për të parë dallimin në mes të Kosovës dhe disa vendeve të BE-së sa i përket lartësisë së kontributeve të paguara, në tabelën e mëposhtme janë paraqitur disa shembuj nga disa shtete.

---

<sup>15</sup> Bashkimi European, Direktiva 92/85/ECC, [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32019L1158&qid=1634928676900#nr6-L\\_2019188EN.01007901-E0006](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32019L1158&qid=1634928676900#nr6-L_2019188EN.01007901-E0006)

Tabela 5. Shembuj nga disa shtetet europiane të lartësisë së kontributeve të paguara

Kontributet nga punëdhënësi dhe punëmarrësi							
Vendi	Kontribuesi	Pensioni I moshës, aftësisë së kufizuar dhe familjarë	Sigurimi shëndetësor dhe pushimi prindëror	Lendimi në punë	Papunësia	Shtesa familjare	Totali
Gjermania	Punëmarrësi	9.3	8.575		1.5		19.375
	Punëdhënësi	9.3	8.575	1.18	1.5		20.555
	Total	18.6	17.15	1.18	3	0	39.93
Italia	Punëmarrësi	9.19					9.19
	Punëdhënësi	23.81	2.68	0.04	2.26	0.68	29.47
	Total	33	2.68	0.04	2.26	0.68	38.66
Sllovenia	Punëmarrësi	15.5	6.46		0.14		22.1
	Punëdhënësi	8.85	7.19		0.06		16.1
	Total	24.35	13.65	0	0.2	0	38.2
Suedia	Punëmarrësi	7					7
	Punëdhënësi	10.91	6.95	0.2	2.91		20.97
	Total	17.91	6.95	0.2	2.91	0	27.97

Mbulimi financiar i Lejes Prindërore

---

Kroacia	Punëmarrësi	20					20
	Punëdhënësi		15	0.5	1.7		17.2
	Total	20	15	0.5	1.7	0	37.2
Kosova	Punëmarrësi	5	0	0	0		5
	Punëdhënësi	5	0	0	0		5
	Total	10	0	0	0	0	10

Dallimi i madh në lartësinë e kontributeve të paguara tregon se Kosova ende mbetet larg sa i përket ofrimit të një sistemi të mirëfilltë të mbrojtjes shoqërore, dhe njëherish tregon se sa i rënduar është Buxheti i Kosovës nga pagesat që bëhen për grupe të ndryshme përfituesish. Derisa vendet e përzgjedhura në këtë shembull kontribuojnë në total nga 27% deri në afër 40%, në Kosovë kontributet mbrrijnë lartësi deri në 10% dhe atë vetëm për pensionet, përderisa të gjitha skemat tjera financohen nga buxheti kombëtar. Kjo tregon se në aspektin afatgjatë një sistem i tillë në Kosovë është i paqëndrueshëm dhe me rritjen e vazhdueshme të numrit të përfituesve do të rriten edhe shpenzimet, dhe si rrjedhojë do të paraqiten vështirësi të pakalueshme për financimin e këtij sistemi. Gjithashtu kompensimi i përfituesve është i ulët për dallim nga shtetet e BE-së, duke marrë parasysh se përfitimet në Kosovë në të shumtën e rasteve konsiderohet se nuk mjaftojnë as për të mbijetuar.

Pasiqë fokusi i këtij punimi është të mbrojtja prindërore, pjesa në vazhdim fokusohet më në detaje në atë se si është e rregulluar kjo çështje në disa shtete të përzgjedhura.

Në definicion por edhe në substancë leja e lehonisë, leja e atësisë si dhe leja prindërore kanë dallime mes vete. Të trija këto kategori janë të rregulluara në mënyra të ndryshme në shtetet individuale të BE-së, por me direktiva të BE-së janë përcaktuar minimumet që duhet plotësuar shtetet e BE-së sa i përket lejes së lehonisë, lejes së atësisë dhe lejës prindërore.

Njëjtë sikurse Organizata Ndërkombëtare e Punës ashtu edhe direktiva e BE-së 92/85/EEC për lejen e lehonave përcakton se lehonat kanë të drejtë në minimum 14 javë (3 muaj) leje të lehonisë, prej të cilave dy javë mund të shfrytëzohen para lindjes së fëmijës.<sup>16</sup> Leja e lehonisë është leje e mbrojtur nga punësimi (përkrahja financiare gjatë lejes si dhe ruajtja e

<sup>16</sup> Bashkimi Europian, Direktiva 92/85/ECC, [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32019L1158&qid=1634928676900#nr6-L\\_2019188EN.01007901-E0006](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32019L1158&qid=1634928676900#nr6-L_2019188EN.01007901-E0006)

vendit të punës) gjatë mungesës së grave të punësuar përgjatë shtatëzanisë dhe pas lindjes së fëmijës. Leja e atësisë është leje i mbrojtur nga punësimi për baballarët e punësuar në kohën kur lindë fëmija apo në muajt e parë pas lindjes së tij.

Direktiva e re e BE-në, Balancimi punë-jetë për prindër dhe kujdestarë<sup>17</sup> ndër të tjera parasheh që nga 14 prilli i vitit 2022 që të gjitha shtetet anëtare të BE-së duhet të ofrojnë së paku 10 ditë të paguara të lejes së atësisë. Deri tani shtete e BE-së kanë pasur minimum 7 ditë të paguara të lejes së atësisë.

Leja prindërore është leje e mbrojtur nga punësimi për prindërit e punësuar, që është shpesh shtesë për periudhat specifike të lejes që mund të shfrytëzohet pas lejes së lehonisë dhe atësisë. Sipas direktivës Balancimi punë-jetë të BE-së të vitit 2019, të gjitha shtetet e BE-së nga viti 2022 duhet të ofrojnë nga 9 javë leje prindërore me pagesë për secilin prind pa mundësi të transferimit të lejes. Për t'i përmbledhur këto kategori, në BE, sipas direktivës për punëtorët shtatëzëna kërkohen të paktën 14 javë leje të lehonisë, derisa direktiva e balancimi punë-jetë kërkon të paktën 10 ditë leje të atësisë si dhe të paktën 4 muaj leje prindërore të cilat nuk mund të transferohen.

Të gjitha shtetet e BE-në ofrojnë një formë të lejes për lehonat. Gjatësia e lejes së lehonisë si dhe kompensimi financiar varion në vende të ndryshme duke filluar me minimumin e përcaktuar nga direktiva e BE-së prej 14 javësh në Gjermani, Suedi e Zvicër; Italia dhe Polonia kanë nga 20 javë derisa në Irlandë kjo shkon në 42 javë (me pagesë janë vetëm 26 javë). Në shumicën e rasteve përfitimet paguhen

---

<sup>17</sup> Official Journal of European Union, DIRECTIVE (EU) 2019/1158 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 20 June 2019 on work-life balance for parents and carers and repealing Council Directive 2010/18/EU, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32019L1158&from=EN>

nga shteti, por ka edhe disa vende si Zvicra, Anglia, Gjermania, Franca dhe Finlanda ku punëdhënësi paguan përfitimet. Në shumicën e shteteve shuma që përfitojnë nënat lehona është më shumë se 50% e pagës së tyre të mëparshme. Në Belgjikë për shembull nënat përfitojnë 82% të pagës së tyre të mëparshme gjatë muajit të parë dhe pastaj 75% për javët tjera të mbetura. Në Angli nënat përfitojnë 90% të pagës mesatare në 6 javët e para, përderisa në 33 javët e mbetura përfitojnë 145 funta në javë.<sup>18</sup>

Leja e atësisë në vendet e BE-së është në përgjithësi më i shkurtër se leja e lehonisë. Mesatarisht baballarët e ri kanë leje atësie nga dy javë. Në Spanjë dhe Austri leja e atësisë është një muaj, derisa në Gjermani, Holandë dhe Itali kanë më pak se një javë leje. Zvicra ka leje që ofrojnë punëdhënësit zakonisht nga 3 në 5 ditë. Pagesa e lejes së atësisë ndjekë modelin e njëjtë si të lejes së lehonisë dhe dallon nga vendi në vend për sa i përket financimit dhe shumës që paguhet. Leja prindërore në përgjithësi merret pas lejes së lehonisë dhe pas lejes së atësisë. Gjithashtu kohëzgjatja e lejes prindërore ndryshon nga vendi në vend. Në disa vende si Irlanda dhe Belgjika, prindërit kanë 18 javë siç e parasheh direktiva e BE-së; deri në 26 javë siç e kanë Holanda, Finlanda, Danimarka dhe Italia. Zvicra nuk ofron leje prindërore.<sup>19</sup>

Direktiva Evropiane për Leje të Lehonisë, Atësisë, dhe Prindërim, nuk e parasheh nëse leja prindërore duhet të mbështetet financiarisht kështu që secili vend e ka të rregulluar këtë çështje në forma të ndryshme. Vendet të cilat ofrojnë leje prindërore që mbështetet financiarisht nga shteti apo punëdhënësi janë Portugalia, Danimarka, Italia, Polonia, Franca dhe Gjermania, derisa disa vende ofrojnë shuma fikse

---

<sup>18</sup> Maternity, Paternity and Parental leave in Europe, <https://www.capital-ges.com/maternity-paternity-and-parental-leave-in-europe/>

<sup>19</sup> Maternity, Paternity and Parental leave in Europe, <https://www.capital-ges.com/maternity-paternity-and-parental-leave-in-europe/>

si Belgjika, Luksemburgu dhe Anglia. Shtetet si Irlanda, Spania, Franca dhe Holanda ofrojnë leje pa pagesë për lejen prindërore. Për dallim prej shteteve tjera, shtetet nordike ofrojnë leje prindërore që nga vitet 90-ta. Suedia ofron 480 ditë të lejes prindërore me pagesë në vlerën 80% të pagës. Norvegjia ofron 49 javë me pagesë prej 100% të pagës ose 59 javë me pagesë 80% të pagës. Finlanda ofron 6 javë vetëm për të atin përveç 158 ditëve të ofruara për lejen prindërore që mund të ndahen nga prindërit dhe paguhet me një shumë fikse nga shteti. Danimarka ofron 32 javë të lejes prindërore që financohet nga shteti.<sup>20</sup>

## **Analizë e shkurtë e disa dokumenteve publike rreth Fondit për Sigurime Shoqërore dhe Lejes Prindërore**

### *Koncept Dokumenti i MPMS për Sigurimet Shoqërore*

Koncept Dokumenti I MPMS<sup>21</sup> i pregatitur në vitin 2018 ka paraparë një ndryshim rrënjësor të sistemit të tanishëm pensional dhe të mbrojtjes shoqërore në Kosovë. Ky dokument përmes opsionit të rekomanduar ka paraparë rirregullim të tërë sistemit duke propozuar një sistem katër shtyllësh të mbrojtjes shoqërore, duke paraparë kështu krijimin e Fondit për Mbrojtje Shoqërore.

---

<sup>20</sup> Maternity, Paternity and Parental leave in Europe, <https://www.capital-ges.com/maternity-paternity-and-parental-leave-in-europe/>

<sup>21</sup> Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të mire, <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40517>

Tabela 6. Propozimi i MPMS-së për fondin për mbrojtje shoqërore

Fondit i Sigurimeve Sociale			
Shtylla 0	Shtylla I	Shtylla II	Shtylla e III
Pensioni bazë	Pensioni i moshës	Pensioni i moshës	Sigurime vullnetare
Pensioni kontributiv para vitit 1999	Pensioni invalidor i punës	Pensioni invalidor	
Pensioni familjar para vitit 1999	Pensioni familjar	Pensioni familjar	
Pensioni invalidor para vitit 1999	Pensioni i parakohshëm		
Pensioni për aftësinë e kufizuar	Mbrojtja prindërore (lehonat e punësuar)		
Pensionet për kategoritë e dala nga lufta	Mbrojtja nga papunësia (benefitet e papunësisë)		
Pensioni i TMK-së	Shtesat e fëmijeve për të punësuar		
Pensionet e parakohshme (Policia, FSK, Shota etj)			

Sipas Koncept Dokumentit të MPMS, në kuadër të shtyllës 0, të gjitha skemat dhe përfitimet do të financohen nga buxheti i shtetit. Shtylla e I-rë do të financohet tërësisht nga Fondi i Sigurimeve Shoqërore, derisa përfituesit e Shtyllës së II-të do të përfitojnë dhe financohen nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës. Shtylla e III-të vazhdon të mbetet njëjtë si shtyllë vullnetare. Sipas Koncept Dokumentit të MPMS-së, mbrojtja prindërore parashihet të financohet nga Fondi i Sigurimeve Shoqërore por nuk përcaktohet shuma

dhe gjatësia se sa do të zgjasë ky kompensim, gjë që parashihet të rregullohet me ligj. Financimi i Fondit të Sigurimeve Shoqërore sipas këtij dokumenti parashihet të bëhet nga kontributet e paguara nga punëdhënësi dhe punëmarrësi në vlerën prej 1,5% secili. Sipas Koncept Dokumentit të MPMS-së, fondi për mbrojtje shoqërore do të financonte mbrojtjen prindërore, mbrojtjen nga papunësia, shtesat për fëmijët, pensionin invalidor i punës, si dhe pensionin e moshës.

### *Koncept Dokumenti i Komisionit AD-Hoc për Sigurime Shoqërore*

Dokumenti i pregatitur nga komisioni ad-hoc i Kuvendit të Kosovës për rregullimin e sigurimeve shoqërore dhe transfereve tjera sociale edhe pse i përfunduar nga grupi i ekspertëve, nuk arriti të aprovohej nga ky komisioni për shkak të shpërndarjes së Kuvendit të Kosovës në vitin 2019. Ky dokument shkon edhe më tutje se Koncept Dokumenti i MPMS-së sa i përket ridizajnimin të sistemit social në Kosovë duke paraparë edhe më në detaje reformën që duhet ndërmarrur në këtë fushë.

Tabela e mëposhtme tregon se si do të dukej sistemi social në Kosovës sipas këtij propozimi.

Tabela 7. Sistemi pensional dhe mbrojtja shoqërore – komisioni ad hoc

Sistemi pensional dhe i mbrojtjes sociale			
Shtylla 0	Shtylla I	Shtylla II	Shtylla III
Shërbimet sociale	Sigurimi pensional: i moshës, invalidor, familjar	Kontributet e definuara të obliguara pensionale	Të drejtat nga sigurimet vullnetare pensionale dhe shëndetësore në treg
Ndihma sociale	Sigurimi nga papunësia		Financimi: Sigurimet vullnetare
Pensioni shtetëror	Sigurimi i mbrojtjes prindërore		
Pensioni i parakohshëm për kategoritë me rrezikshmëri të lartë: FSK, Policia, Zjarrëfikësit, Minatorët etj.	Sigurimi i pushimi mjekësor (sick leave benefits)		
Pensioni i aftësisë së kufizuar	Financimi: Kontributet e obliguara të punëdhënësve dhe punëmarrësve		
Kategoritë e luftës			
TMK dhe Trepça			
Veteranët			
Sigurimi i mbrojtjes së fëmijëve			
Sigurimi kombëtar shëndetësor			
Financimi: Buxheti Kombëtar			

Njëjtë sikur Koncept Dokumenti i MPMS-së, ky dokument parasheh një sistem katër shtyllësh dhe futjen e disa kategorive të reja nën mbrojtjen shoqërore të cilat nuk

implementohen aktualisht në Kosovë. Pika e parë dhe më e rëndësishme është se rritet shkalla e kontributeve të paguara si nga punëdhënësi ashtu edhe nga punëmarrësi dhe nga 10% sa është aktualisht shkon në 20% që është afer mesatares në shtetet e UE-së. Sipas këtij propozimi pagesat e kontributeve ndahen si në vijim: 5%+5% për Shtyllën e Dytë (II), 3.5%+3.5% për pensionet në Shtyllën e Parë (I), 0.5%+0.5% për Mbrojtjen Prindërore (I), 0.5% +0.5% për Mbrojtjen nga Papunësia (I), 0.5%+0.5% për kompensimet e pushimit mjekësor.

Duke marë parasysh raportet e Fondit për Kursime Pensionale nga e kaluara do të mund të parashikojmë se sa mjete do të mblidheshin për secilen shtyllë ndaras. Në tabelën e mëposhtme sqarohet propozimi i komisionit ad-hoc për Fondin për Sigurimin Shoqëror, në përqindje dhe në shuma që do të mblidheshin.

Tabela 8. Parashikimi për kontribute sipas shtyllave

Sistemi i mbrojtjes sociale në Kosovë, kontributet në përqindje						
Vendi	Kontribuesi	Shtylla II	Shtylla I	Pushimi mjekësor	Papunësia	Pushimi prindëror
Kosova	Punëmarrësi	5	3.5	0.5	0.5	0.5
	Punëdhënësi	5	3.5	0.5	0.5	0.5
	Total	10	7	1	1	1
2015		€ 137,519,615.00	€ 96,263,730.50	€ 13,751,961.50	€ 13,751,961.50	€ 13,751,961.50
2016		€ 151,503,736.00	€ 106,052,615.20	€ 15,150,373.60	€ 15,150,373.60	€ 15,150,373.60
2017		€ 159,757,519.00	€ 111,830,263.30	€ 15,975,751.90	€ 15,975,751.90	€ 15,975,751.90
2018		€ 173,852,170.00	€ 121,696,519.00	€ 17,385,217.00	€ 17,385,217.00	€ 17,385,217.00
2019		€ 186,312,328.00	€ 130,418,629.60	€ 18,631,232.80	€ 18,631,232.80	€ 18,631,232.80
2020		€ 194,364,329.00	€ 136,055,030.30	€ 19,436,432.90	€ 19,436,432.90	€ 19,436,432.90
2021	Parashikim	€ 202,364,329.00	€ 141,655,030.30	€ 20,236,432.90	€ 20,236,432.90	€ 20,236,432.90
2022	Parashikim	€ 210,364,329.00	€ 147,255,030.30	€ 21,036,432.90	€ 21,036,432.90	€ 21,036,432.90
2023	Parashikim	€ 218,364,329.00	€ 152,855,030.30	€ 21,836,432.90	€ 21,836,432.90	€ 21,836,432.90
2024	Parashikim	€ 226,364,329.00	€ 158,455,030.30	€ 22,636,432.90	€ 22,636,432.90	€ 22,636,432.90
2025	Parashikim	€ 234,364,329.00	€ 164,055,030.30	€ 23,436,432.90	€ 23,436,432.90	€ 23,436,432.90
2026	Parashikim	€ 242,364,329.00	€ 169,655,030.30	€ 24,236,432.90	€ 24,236,432.90	€ 24,236,432.90

Sipas kësaj ndarje, shtylla e I dhe II tërësisht mbulohe nga kontributet e paguara derisa shtylla 0 do të financohet nga buxheti kombëtar. Propozimi parasheh se në rast të mungesës së mjeteve financiare, deficitin e shtyllës së I-rë do ta mbulojë buxheti kombëtarë.

Për qëllimin e këtij punimi, në vijim sqarohet se si është paraparë mbrojtja prindërore në bazë të këtij dokumenti. Mbrojtja prindërore është vendosur në shtyllën e I-rë dhe financohet nga punëdhënësi dhe punëmarrësi në mënyrë të barabartë me pagesën e kontributeve nga 0.5% secili. Punëdhënësi mbulon kompensimin e obliguar për 2 javë për nënën dhe një javë për të atin e fëmijës me rastin e lindjes së fëmijut. Nga Fondi mbulohet pjesa tjetër, ku nëna kompensohet në shkallën prej 70% të pagës bazë në kohëzgjatje për 6 muaj derisa për të atin e fëmijës kohëzgjatja e kompensimit do të jetë deri në dy muaj. Për të përfituar këtë kompensim, përfituesi duhet të ketë jo më pak se dy vjet kontribuim të pandërprerë në shtyllën e I-rë. Të atit i ipet mundësia të zgjedhë nëse dëshiron të marrë lejen prindërore apo jo, por nuk lejohet transferimi i dy muajve të nëna.<sup>22</sup>

### *Punimet tjera rreth fondit për sigurime shoqërore dhe lejes prindërore*

Viteve të fundit në Kosovë janë publikuar disa punime kryesisht nga organizata të shoqërisë civile në lidhje me propozimet për rirregullimin e sistemit pensional dhe social në Kosovë. Në linjë me qëllimin e këtij punimi, pjesa në vazhdim analizon dy punime që në thelb kanë njëren nga këto dy elemente kryesore, krijimin e Fondit për Mbrojtje Shoqërore si dhe irregullimin e Lejes Prindërore.

Punimi “Reforma Pensionale-Rruga që duhet ndjekur”,

---

<sup>22</sup> Komisioni Ad-hoc I Kuvendit të Kosovës, për rregullimin e Sigurimeve Sociale dhe Transfereve Tjera Sociale, Korrik/Gusht 2019.

publikuar nga INDEP<sup>23</sup> në vitin 2018, propozon krijimin e Fondit të Mbrojtjes Shoqërore si dhe një sistem pensional katër shtyllësh. Sa i përket krijimit të Fondit për Mbrojtje Shoqërore, propozohet që fondit i krijuar të financohet me kontributin prej 1.5% në paga si nga punëdhënësi ashtu edhe nga punëmarrësi. Fondi do të financonte shtyllën e parë ku përfshihet pensioni invalidor i punës, pensioni familjar, garantimi i pensionit të moshës, pensioni i parakohshëm, pagesa e lehonisë, si dhe pagesa e papunësisë.

Modeli i propozuar në këtë punim nuk flet për lejen prindërore por vetëm për pagesën e lehonave. Karakteristikat kryesore të këtij propozimi janë se lehonat paguhen për 12 muaj, dhe se lehonat duhet të kenë kontribuar se paku 1 vit në shtyllën e I-rë dhe të II-të para se të mund të përfitojnë. Vlera e pagesës nuk duhet të jetë më pak se paga minimale dhe jo më shumë se paga mesatare e sektorit publik. Gjithashtu financimi i lejes së lehonisë bëhet nga Fondi dhe si rrjedhojë bizneseve do u hiqet një barrë e madhe që bartin me sistemin aktual ku duhet paguar 6 muaj leja e lehonisë dhe në të njëjtën kohë ndoshta duhet paguar edhe një puntore për 6 deri 12 muaj nëse shfrytëzohet leja e plotë e lehonisë sipas kornizës ligjore aktuale.<sup>24</sup>

Punimi tjetër i cili në fokus ka lejen prindërore është publikuar në vitin 2017 nga Instituti Demokraci për zhvillim (D4D). Modeli I propozuar nga D4D shkon përtej kërkesës minimale që kërkohet nga Direktiva e BE-së mbi Balancimin e Punës dhe Jetës. Sipas këtij propozimi, leja e lehonisë, leja e atësisë dhe leja prindërore do të zgjaste 14 muaj, prej të cilëve 9 muaj me pagesë dhe 4 muaj pa pagesë. Leja e lehonisë do të ishte 4 muaj dhe do të paguhej nga punëdhënësi me

---

<sup>23</sup> Instituti për Politika Zhvillimore-INDEP, [https://indep.info/wp-content/uploads/2018/10/Reforma-Pensionale\\_Rruga-qe-duhet-ndjekur\\_INDEP.pdf](https://indep.info/wp-content/uploads/2018/10/Reforma-Pensionale_Rruga-qe-duhet-ndjekur_INDEP.pdf), Tetor 2018.

<sup>24</sup> Instituti për Politika Zhvillimore-INDEP, [https://indep.info/wp-content/uploads/2018/10/Reforma-Pensionale\\_Rruga-qe-duhet-ndjekur\\_INDEP.pdf](https://indep.info/wp-content/uploads/2018/10/Reforma-Pensionale_Rruga-qe-duhet-ndjekur_INDEP.pdf), Tetor 2018..

70% të pagës bazë. Leja e atësisë parashihet të jetë 1 muaj i gjatë dhe do të paguhej nga punëdhënësi me 70% të pagës bazë. Leja prindërore parashihet të ndahet me nga 4 muaj për secilin prind, ku secilit prind nga 2 muaj të lejes prindërore i mbulohet në shkallen 50% të pagës mesatare dhe paguhet nga buxheti i shtetit.<sup>25</sup> Në përgjithësi barra e pagesës parashihet t'i takojë punëdhënësit për 5 muaj dhe buxhetit të shtetit për 4 muaj, derisa 4 muaj do të jenë pa pagesë.

## Modalitetet e mundshme të lejes prindërore

Korniza aktuale ligjore e Kosovës nuk parasheh fare leje prindërore por vetëm lejen e lehonisë dhe dy ditë me pagesë për të atin me rastin e lindjes së fëmijut. Barra e mbulimit të shpenzimeve i bie punëdhënësit dhe buxhetit të shtetit në kombinim. Përkatësisht, punëdhënësi duhet të paguaj për 6 muaj 70% të pagës së lehonës dhe në të njëjtën kohë duhet të paguaj edhe një punëtorë për kohën sa mungon lehona në punë. Kjo kosto e dyfishtë për punëdhënësin ka ndikim negativ në bilancin e kompanisë, gjë e cila reflektohet edhe në hezitimin e punëdhënësve për të punësuar një grua të re e cila potencialisht do të bëhej nënë në të ardhmen.

Në shumë studime dhe analiza të bëra në të kaluarën është dëshmuar se kjo është një ndër pengesat kryesore të punësimit të gruas. Gjithashtu, sistemi aktual i Kosovës nuk përkon me direktivën e BE-së për Balancim mes punës dhe jetës, e cila parasheh ofrimin e lejes prindërore. Shumë shtete të BE-së ka kohë që kanë filluar implementimin e lejes prindërore dhe kjo është bërë një normë standarde në vendet e zhvilluara. Për më shumë leja prindërore është jodiskriminuese dhe njeh edhe përgjegjësinë e babait në rritjen e fëmijës.

---

<sup>25</sup> Demokraci për Zhvillim-D4D, Ndryshimi I Paradigmës-Barazi përmes lejes prindërore, [https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/D4D\\_PI\\_13\\_SHQ\\_WEB.pdf](https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/D4D_PI_13_SHQ_WEB.pdf), faqe 42 dhe 43, viti 2017.

Pasi që Kosova ka synim integrimin në BE-në atëherë duhet shikuar modalitetet se si do të mund të implementojë së paku Direktivën e BE-së për leje të lehonisë, leje të atësisë dhe prindërimit, e cila vendos minimumin sa i përket këtyre lejeve.

Dokumentet e paraqitura në këtë punim shqyrtojnë disa modele se si do të mund të implementohej kjo direktivë. Nëse marrim pjesë nga secili model I paraqitur do të mund të rekomandonim një model i cili do t'i përshtatej ambientit shoqëror në Kosovë. Modeli i propozuar në këtë punim do të tentoj të gjejë balancën në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit, shtetit, si dhe fëmijës së posalindur, duke u siguruar së Direktiva e BE-së për Balancim Punë-jetë është duke u implementuar.

Duke marrë te gjitha këto parasysh, rrjedhimisht vijmë në përfundim se krijimi i fondit për sigurime shoqërore është i pashmangshëm dhe njëherit kjo rekomandohet edhe në dokumentet e përmenduara në këtë punim.

Krijimi i FSSH do të thotë rritje e kontributeve të paguara si nga punëdhënësi ashtu edhe nga punëmarrësi. Kjo ndarje e përgjegjësisë në shoqërinë kosovare do të thotë se barra do të shpërndahet horizontalisht dhe nuk do të jetë barrë e koncentruar vetëm te ata të prekur në mënyrë direkte, por gjithashtu edhe përfitimi do të jetë i përgjithshëm nga e gjithë shoqëria. Duke marrë parasyhsë bazën shumë të ulët të kontributeve të paguara sipas sistemit aktual në Kosovë në krahasim me vendet e zhvilluara, rritja e kontributeve vetëm do të na përfronte me shtetet e zhvilluara dhe Bashkimit Evropian specifikisht. Disa nga modelet e paraqitura më lartë do të analizohen në mënyrë të thellë sa i përket mundësisë së implementimit dhe kostos së mundshme nëse implementohen.

## Modeli sipas Direktivës për Balancim Punë-Jetë

Modeli i parë është i bazuar në minimumin e direktivës së BE-se për Balancim punë-jetë që parasheh lejen e lehonisë për 14 javë, lejen e atësisë për 10 ditë dhe lejen prindërore për 9 javë për secilin prind. Nëse marrim për bazë propozimin e komisionit ad hoc parlamentar për Sigurime Shoqërore dhe Direktivën e BE-së atëherë leja prindërore do të dukej si në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 9. Modeli sipas Direktives së UE-së**

<b>Kostoja e pushimit prindëror sipas Direktivës së BE-së dhe modelit të komisionit ad hoc për FSSH, viti 2020</b>				
	<b>Nëna</b>	<b>Baba</b>	<b>70% pagës mes.</b>	<b>50% pagës mes.</b>
Nr i përfituesve potencial	2594	8938		
Paga mesatare	€ 466.00		€ 326.20	€ 233.00
Pushimi i lehonisë , 70% pagës mesatare, 3 muaj FSSH	€ 2,538,488.40			
Pushimi i atësisë, 70% pagës mesatare, 2 javë FSSH		€ 1,457,787.80		
Pushimi prindëror, 50% pagës mesatare, 4 muaj FSSH	€ 1,208,804.00	€ 4,165,108.00		
<b>Totali</b>		<b>€ 9,370,188.20</b>		
Propozimi i Komisionit ad hoc, 0.5% + 0.5% e kontributeve		<b>€ 19,436,432.90</b>		

Tabela e mësipërme përkon me kërkesat minimale të Direktivës së BE-së për Balancim Punë-jetë, ku kërkohet nga shtetet e BE-së të plotësojnë këto kritere minimale sa i përket lejes së lehonisë (14 javë), lejes së atësisë (10 ditë pune), si dhe lejes prindërore (9 javë për secilin prind). Numri i

përfituesve potencial është marrë nga punimi “Ndryshimi i Paradigmës - Barazi përmes lejes prindërore”<sup>26</sup> publikuar në vitin 2017, derisa shuma e mbledhur nga kontributet e paguara nga punëdhënësit dhe punëmarrësit është llogaritur sipas propozimit të Komisionit ad-hoc për reformë pensionale, i cili është bazuar në të dhënat e FKPK-së për vitin 2020. Shkalla e pagesës është marrë si një mesatare e të gjitha propozimeve por është edhe një mesatare që implementohet në vendet evropiane në këtë aspekt. Paga mesatare është marrë paga bruto për vitin 2020 sipas ASK-së.

Për të përmbushur minimumin e kërkuar nga Direktiva e BE-së për leje të lehonisë, atësisë, dhe prindërimit, kostoja e përafërt totale do të ishte rreth 14.7 milion euro në vit e cila do të mbulohej në tërësi nga FSSH ku siç tregon tabela do të ishte e mjaftueshme pagesa prej 1% në total.

Ky model ka disa përparësi. Së pari përmbush minimumin e Direktives Evropiane të lartpërmendur, punëdhënësi dhe buxheti i shtetit nuk kanë kosto shtesë, si dhe mjafton pagesa prej 0.5% nga punëdhënësi dhe punëmarrësi që të mbulohet e gjithë skema e lejes prindërore. Në total lehona mund të marrë 5 muaj lejedherisa babai merr 2 muaj e gjysmë në total.

### *Modeli sipas komisionit ad-hoc parlamentar për reformë pensionale*

Modeli i dytë i paraqitur më poshtë është modeli i propozuar nga Komisioni ad-hoc parlamentarë për reformë pensionale.

---

<sup>26</sup> Demokraci për Zhvillim-D4D, Ndryshimi I Paradigmës-Barazi përmes lejes prindërore. [https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/D4D\\_PI\\_13\\_SHQ\\_WEB.pdf](https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/D4D_PI_13_SHQ_WEB.pdf).

**Tabela 10. Kostot sipas modelit të Komisionit Ad-hoc**

<b>Modeli I pushimit të lehonisë rekomanduar nga komisioni ad hoc parlamentar 2019</b>				
	<b>Nëna</b>	<b>Baba</b>	<b>70% pagës</b>	<b>50% pagës</b>
Nr i përfituesve potencial	2594	8938		
Paga mesatare	€ 466.00		€ 326.20	€ 233.00
Pushimi i lindjes, 70% pagës mesatare, 2 javë punëdhënësi	€ 575,608.60			
Pushimi i lindjes, 70% pagës mesatare, 6 muaj, FSSH	€ 5,076,976.80			
Pushimi i atësisë, 70% pagës mesatare, 1 javë nga punëdhënësi	€ 991,671.10			
Pushimi i atësisë, 70% pagës mesatare, 2 javë FSSH		€1,983,342.20		
<b>Totali FSSH</b>		<b>€ 7,060,319.00</b>		
<b>Totali nga punëdhënësi</b>		<b>€ 1,567,279.70</b>		
Sipas propozimit të Komisionit ad hoc, totali i 0.5% + 0.5% e kontributeve të mbledhura nga punëdhënësi dhe punëmarrësi		<b>€ 19,436,432.90</b>		

Ky model është kalkuluar me të dhënat e përdorura nga modeli i mëparshëm sa i përket numrit potencial të përfituesve. Në përgjithësi sipas rekomandimit të komisionit

ad-hoc, leja e lindjes do të zgjaste 6 muaj e dy javë, ku dy javë do të kompenzoheshin nga punëdhënësi dhe 6 muaj nga FSSH, derisa leja e atësisë do të zgjaste 2 muaj e një javë, ku 1 javë do të kompenzohej nga punëdhënësi dhe 2 muaj nga FSSH. Kompensimi do të ishte 70% e pagës bazë.

Ky model nuk parasheh leje prindërore, gjë që e bën që në fillim të jetë në kundërshtim me Direktiven e BE-së për leje të lehonisë, atësisë, dhe të prindërimit. Gjithashtu, kostoja për tri javët e para do t'i takonte punëdhënësit për ta mbuluar, derisa koston kryesore do të ta barte FSSH. Totali që do të paguhej nga FSSH sipas parashikimeve do të ishte shumë më i ulët se shuma e mbledhur nga kontributet e parashikuara prej 1% për FSSH. Nëse do të implementohej ky model atëherë kontributet e mbledhura për ta financuar këtë model do të mjaftonin në shkallën e kontributeve prej 0.25% për punëdhënësin dhe të njejtën për punëmarrësin. Gjithashtu e metë e këtij modeli mund të konsiderohet edhe pagesa e dyfishtë nga punëdhënësi, një pjesë në mënyrë të drejtëpërdrejtë te përfituesi dhe pagesa tjetër përmes kontributeve në FSSH. Buxheti i shtetit me këtë model do të mbetej i paprekur, pra shteti nuk do të kontribonte fare.

### *Modeli sipas D4D propozuar në vitin 2017*

Modeli i tretë është modeli i rekomanduar nga D4D<sup>27</sup> në vitin 2017. Ky model përveç që përmbush dhe tejkalon kriteret minimale të Direktivës Evropiane për leje të lehonisë, atësisë dhe prindërimit.

---

<sup>27</sup> Demokraci për Zhvillim-D4D, Ndryshimi I Paradigmës-Barazi përmes lejes prindërore, [https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/D4D\\_PI\\_13\\_SHQ\\_WEB.pdf](https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/D4D_PI_13_SHQ_WEB.pdf), viti 2017.

Tabela 11. Kostoja sipas modelit të D4D-së

<b>Kostoja e pushimit prindëror sipas modelit të D4D dhe modelit të komisionit ad hoc për sigurime shoqërore, viti 2020</b>				
	<b>Nëna</b>	<b>Baba</b>	<b>70% pagës</b>	<b>50% pagës</b>
Nr i përfituesve potencial	2594	8938		
Paga mesatare	€ 466.00		€ 326.20	€ 233.00
Pushimi i lehonisë, 70% pagës mesatare, 4 muaj, punëdhënësi	€ 3,384,651.20			
Pushimi i atësisë, 70% pagës mesatare, 1 muaj punëdhënësi		€ 2,915,575.60		
Pushimi prindëror, 50% pagës mesatare, 4 muaj, buxheti i shtetit	€ 1,208,804.00	€ 4,165,108.00		
Pushimi prindëror, 4 muaj pa pagesë				
<b>Totali i shumës që paguan punëdhënësi</b>	€ 6,300,226.80			
<b>Totali i shumës që paguan shteti</b>	€ 5,373,912.00			
<b>Propozimi i Komisionit ad hoc, 0.5% + 0.5% e kontributeve</b>	€ 19,436,432.90			

Sipas këtij modeli leja e lehonisë do të ishte 4 muaj, i atësisë 1 muaj, ndërsa leja prindërore do të ishte 8 muaj për të dy prindërit, prej të cilëve 4 me pagesë. Financimi i këtij modeli do të bëhej nga punëdhënësi, në kombinim me buxhetin e shtetit. Sipas të dhënave të përdorura në shembujt e mëparshëm, ky model punëdhënësit do t'i kushtonte rreth 5.5 milion euro në vit derisa shtetit do t'i kushtonte rreth 10.8 milion euro në vit. Sipas këtij modeli punëdhënësi paguan në total një muaj më pak se sistemi aktual që është duke u

implementuar në Kosovë.

Duke shikuar këto tri modele dhe duke pasur parasyshë zhvillimet e viteve të fundit sa i përket lejes prindërore në shtetet e BE-së, por edhe duke marrë për bazë edhe diskutimet dhe dokumentet zyrtare rreth krijimit të Fondit për Sigurime Shoqërore, është hapur një mundësi e mirë për të shtyrë përpara një model që do të ngërthente interesat e të gjitha palëve që janë të përfshira.

## Modeli i rekomanduar

Modeli i rekomanduar nga ky punim do të marrë parasyshë krijimin e fondit për sigurime shoqërore, duke implementuar Direktivën e BE-së 2019/1158 për Balancim Punë-Jetë, interesin e punëdhënësit dhe punëmarrësit, interesin e grupeve të ndryshme të interesit, por mbi të gjitha interesin e fëmijut të posalindur. Për më tepër, ky model merr në konsideratë edhe gatishmërinë e qytetarëve në Kosovë, e nxjerrë nga të dhënat e pyetësorit të realizuar nga Instituti D4D lidhur me gatishmërinë e qytetarëve për të kontribuar më shumë për të përfituar mbështetje financiare për lejen prindërore.

Në pyetjen se a do të merrni leje prindërore i cili do të mbështetej financiarisht nga Fondi për Sigurime Shoqërore, përgjigjet e të anketuarve ishin si në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 12. Përgjigjet në pyetjen e parashtruar nga D4D**

<b>A do të merrnit pushim prindëror i cili do të mbështetej financiarisht nga fondi për sigurime shoqërore</b>				
	PO, nëse paguhet i tëri	JO	PO, nëse paguhet pjesërisht	Refuzoj të përgjigjem
Gra	61%	19.10%	15.30%	4.60%
Burra	30.50%	42.20%	19.40%	7.90%
Bashkë	45.40%	30.80%	17.50%	6.30%

Pra, përkundër që leja prindërore do të paguhej nga FSSH, gatishmëria e qytetarëve për të shfrytëzuar këtë leje varion nga 61% e grave në vetëm 30% e burrave. Derisa refuzimi në këtë masë nga burrat mund të shpjegohet deri diku me mentalitetin e shoqërisë kosovare, refuzimi i gruas kërkon studim të mëtutjeshëm për të gjetur arsyet e vërteta të refuzimit në këtë masë.

Në pyetjen se sa janë të gatshëm të paguajnë kontribute shtesë për të përfituar nga Fondi për Sigurime Shoqëror, përgjigjet e dhëna janë si në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 13. Përgjigjet në pyetjen e parashtruar nga D4D**

<b>A do të paguanit kontribute shtesë në fondin për sigurime shoqërore për të përfituar mbështetje financiare si i punësuar si dhe kur mbeteni pa punë</b>			
	PO	JO	Refuzoj të përgjigjem
Gra	33.10%	53.80%	13%
Burra	36.70%	52.30%	11%

Gatishmëria e responentëve për të paguar kontribute shtesë ishte 33.10% nga gratë dhe 36.7% nga burrat, derisa refuzimi për përgjigje ishte 53.8% për gratë dhe 52.3% nga burrat. Vërehet dallim i thellë në gatishmërinë e grave për të paguar kontribute shtesë për të shfrytëzuar lejen prindërore në relacion me gatishmërinë e burrave, respektivisht 61% për të shfrytëzuar lejen prindërore nëse paguhet nga FSSH. Përgjigjet e burrave për të paguar kontribute shtesë janë konsistente me gatishmërinë e tyre për të shfrytëzuar lejen prindërore nëse financohet nga FSSH.

Në pyetjen se sa përqind kontribute shtesë janë të gatshëm të paguajnë për të shfrytëzuar përfitimet nga FSH-re përgjigjet janë si më poshtë.

Tabela 14. Përgjigjet në pyetjen e parashtruar nga D4D

Sa % kontribute jeni të gatshëm të paguani për fondin për sigurime shoqërore		
% e kontr.	Gra	Burra
0-2%	33.50%	25%
2-4%	37%	48%
4-6%	22.50%	13%
6-8%	4.60%	6.50%
8-10%	2.30%	7.50%

Nëse e marrim si rrjedhojë logjike e dy pyetjeve të mëhershme, presupozojmë që ata që janë të gatshëm të shfrytëzojnë përfitimet nga FSSH dhe që shprehen gatishmërinë të paguajnë rezulton se mbi 70% të tyre janë të gatshëm të kontribuojnë nga 0-2 deri 2-4%. Gatishmëria e tyre për të kontribuar në këtë masë është inkurajuese sidomos kur modeli i propozuar do të mund të mbulohej me vetëm 0.25% të kontributeve të paguara nga punëmarrësi në baza mujore.

Shteti do të duhej të ishte balancuesi i të gjitha këtyre interesave si institucioni kryesorë ligjëvënës. Modeli i propozuar shihet si balancues i këtyre interesave. Ky model bazohet në pagesën e kontributeve për Fondin për Sigurime Shoqërore ashtu sic e propozon komisioni ad-hoc për reforme pensionale dhe kontributet sipas këtij propozimi janë 0.5%+0.5% për lejen prindërore, vlera e njëjtë e paguar si nga punëdhënësi ashtu edhe nga punëmarrësi.

Tabela 15. Kontributet dhe dedikimi i tyre sipas komisionit ad hoc

% e kontributeve në shtylla sipas propozimit të komisionit ad hoc							
	Buxh. Shtetit	Pun. Dhën.	Pun. Marrë.	Pun. Dhën.	Pun. Marrë.	Vullnet are	
	Shtylla 0	Shtylla 1		Shtylla II		Shtylla III	
Pensioni moshës, invalidor, familjar		3.50%	3.50%	5%	5%		
Mbrojtja prindërore		0.50%	0.50%				
Mbrojtja nga papunësia		0.50%	0.50%				
Sëmundjet afatgjate		0.50%	0.50%				

Leja prindërore sipas këtij modeli financohet plotësisht nga kontributet e paguara nga punëdhënësi dhe punëmarrësi. Bazuar në të dhënat nga FKPK-së për vitin 2020, nëse do të ishin paguar 1% për lejen e lehonisë gjatë vitit 2020 do të ishin mbledhur rreth 19.5 milion euro. Modeli i rekomanduar do të kushtonte sa gjysma e kësaj shume, dhe rrjedhimisht edhe përqindja e kontributeve të parapara do të mund të ulej në vetëm 0.25% kontribute shtesë për punëdhënësin dhe punëmarrësin.

Tabela 16. Kosto e modelit të rekomanduar

Modeli i rekomanduar				
	Nëna	Baba	70% pagës	50% pagës
Nr i përfituesve potencial	2594	8938		
Paga mesatare bruto sipas ASK-së në vitin 2020	€ 466.00		€ 326.20	€ 233.00
Pushimi i lehonisë, 70% pagës mesatare, 4 muaj, FSSH	€ 3,384,651.20			
Pushimi i atësisë, 70% pagës mesatare, 2 javë FSSH		€ 1,457,787.80		
Pushimi prindëror, 50% pages mesatare, 2 muaj secili, FSSH	€ 1,208,804.00	€ 4,165,108.00		
Pushimi prindëror 2 muaj pa pagesë				
<b>Totali FSSH</b>		<b>€ 10,216,351.00</b>		
Propozimi I Komisionit ad hoc, 0.5% + 0.5% e kontributeve		€ 19,436,432.90		

Interesi i nënës është që të ketë kohë të mjaftueshme në fazën e parë të rritjes së fëmijut dhe të mos ketë brengë financiare apo brengë se do ta humbë vendin e punës. Gjithashtu duhet pasur parasysh se mungesa e gjatë në vendin e punës do të mund të ndikonte negativisht në karrierën profesionale të nënës. Sipas këtij modeli nëna do të kishte 7 muaj leje të lindjes dhe leje prindërore, prej të cilave 6 muaj do të jenë leje me pagesë dhe një muaj pa pagesë. Babai do të kishte 3 muaj e gjysmë leje, prej të cilave 2 muaj e gjysmë me pagesë.

Interesi i punëdhënësit do të mbrohej gjithashtu pasi që

barrën e kompensimit financiar do ta barte Fondi për Sigurime Shoqërore. Sipas modelit të përdorur edhe në shembujt e mëparshëm, shuma e mbledhur nga kontributet do të ishte mëse e mjaftueshme për financimin e këtij modeli. Shteti në këtë rast do të përkujdesej për implementimin sa më të mirë të këtij modeli dhe nuk do të kishte kosto direkte për buxhetin e shtetit përveç në rastet kur shuma e mbledhur nga kontributet nuk do të mbulonte tërësisht koston e lejes prindërore.

## Lista e publikimeve

### Interesi Publik

#1 Sejdiu, Dardan dhe Kastriot Jahaj. Janar 2013. ‘Taksa’ e fshehur: pse kosovarët paguajnë më shumë?

#2 Gashi, Drilon and Shoghi Emerson. Maj 2013. Klasë në vete: Patronazhi dhe ndikimi i tij në mobilitetin shoqëror në Kosovë

#3 Sutaj, Visar and Leon Malazogu. Janar 2013. Le të ngrihet shoqëria civile e vërtetë: Roli i shoqatave me anëtarësi në formësimin e vendimmarrjes në shërbim të interesit publik

#4 Miftari, Naser. Shtator 2013. Sfida e konsolidimit – Fuqizimi i pavarësisë së institucioneve të medias në Kosovë

#5 Ardiana Gashi dhe Artane Rizvanolli; Me kontribut nga Natalya Wallin, Rezarta Delibashzade dhe Ngadhnjim Halilaj. 25 shkurt 2015. Sa kushton patriarkati?

#6 Rezarta Delibashzade, Laura Flemming, Ramadan Klisurica, Agon Maliqi dhe Rina Abazi. 11 Nëntor 2015 Rëndësia e grupeve të interesit: Praktikat, rastet studimore dhe mësimet e nxjerra

#7 Dukagjin Pupovci dhe Gersi Gashi. Nëntor, 2015 Reformimi i Universiteti të Prishtinës – mission i mundur?

#8 Leon Malzogu dhe Bernard Nikaj; Me kontribut nga Gulliver Brady. Nëntor, 2016. Nxitje për llogaridhënie dhe performancë më të mirë në arsimin e lartë

#9 Jehona Serhati, me kontribut redaktues nga Abby Riley. Janar, 2017. Stimujt për reformë: Rritja e mundësive për nxënësit/et dhe të diplomuarit/at e AAP-së në tregun e punës

#10 Isuf Zejna. Korrik 2017. Zhvillimi i turizmit përmes politikave dhe legjislationit efikas.

---

#11 Visar Sutaj. Tetor 2017. Sa të pavarura janë autoritetet rregullatore në Kosovë?

#12 Linda Abazi Morina dhe Rezarta Delibashzade. Me contribute nga Ajete Kërqeli dhe Valëza Zogiani. Nëntor 2017. Joaktiviteti i grave në tregun e punës.

#13 Ajete Kërqeli. Me kontribute nga Ardiana Gashi. Dhjetor 2017. Ndryshimi i paradigmës – Barazi përmes lejes prindërore.

#14 Vjollca Krasniqi. Mars 2018. Gjendja e vullnetarizmit në Kosovë: Sfidat dhe perspektivat.

#15 Xhavit Rexhaj. Me kontribut nga Rasim Alija. Prill 2018. Funksionimi i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës: Analizë e punës dhe vendimeve.

#16 Krenar Gashi dhe Gersi Gashi. Rishikuar nga Dr. Besnik Pula. Nëntor 2018. Zanafilla plus dhjetë: Analizë e dekadës së pare të shtetësisë së Kosovës.

#17 Aliriza Arenliu dhe Gersi Gashi, me contribute nga Elmedina Bajgora. Mars 2019. Matja dhe vlerësimi i politikave të riintegrit: Politika të bazuara në dëshmi për të siguruar riintegrim të qëndrueshëm.

#18 Alba Boshnjaku dhe David JJ Ryan. Qershor 2019. Parental Rights in Kosovo: Legal analysis regarding the proposed amendments to maternity and parental leave (vetëm në anglisht).

#19 Kaltrina Temaj. Rishikuar nga: Valëza Zogjani. Shtator 2019. Inclusion of Women in decision-making and local governance in Kosovo (vetëm në gjuhën angleze).

#20 Albert Krasniqi. Dhjetor 2020. Analizë mbi veprimtarinë e Kuvendit të Kosovës në periudhën 2019-2020.

#21 Judita Krasniqi. Janar 2021. Kush e paguan çmimin

më të lartë? Ndikimi i Covid-19 në punësimin e grave në Kosovë.

#22 Instituti D4D. Tetor 2021. Komuna e Mitrovicës së Jugut: Reformë apo menaxhim më i mire i administrates lokale.

*Këto punime dhe të tjera të publikuara nga instituti D4D, mund t'i lexoni në vegëzën: [www.d4d-ks.org/punime](http://www.d4d-ks.org/punime).*

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

368.4(496.51)

Fondi i Sigurimeve Shoqërore : mbulimi financiar i Lejes Prindërore / ky punim është përgatitur nga Instituti Demokraci për Zhvillim. - Prishtinë : Demokraci për zhvillim, 2021. - 48 f. : ilustr ; 28 cm. - (Interesi publik ; Seria 23)

Sigurimet Shoqërore – Kosovë

**ISBN 978-9951-823-19-7**

Aleph [000099442]



Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup i analistëve që po brengoseshin gjithnjë e më shumë që procesi i shtetndërtimit e kishte lënë anash demokracinë.

Vizioni i D4D-së është të promovojë një qytetari aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe e përdor arenën publike për përfaqësim dhe vendim-marrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e resurseve që janë efikase, të shpejta, afatgjate dhe që sjellin zhvillim të barabartë.

D4D ndikon në politikat specifike, promovon një qasje ndër-sektoriale për zgjidhjen e problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime në rritje dhe operon me efektivitet maksimal në mënyrë që të promovojë plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së, ju lutemi vizitoni faqen tonë elektronike: [www.d4d-ks.org](http://www.d4d-ks.org)



Democracy for Development  
Demokraci për zhvillim  
Demokratija za razvoj

SOCIAL  
DIALOGUE  
4 SOCIAL  
JUSTICE

National Alliance for Social  
Justice & Socio-economic rights



ISBN 978-9951-823-19-7



9 789951 823197